# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-444253**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Akuza të forta nga protesta: Rama dhe Vuçiç, arkitektët e ndarjes së Kosovës |
| ADRESA | `https://piranjat.al/aktualitet/akuza-te-forta-nga-protesta-rama-dhe-vucic-arkitektet-e-ndarjes-se-ko-i104108` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 18:50:10 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 18:42:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `64c3928dba4314566f0fceef5c989e3b650a652b47dce81b28064c462758d084` |
| TEKSTI | `5824ccd042d5b8e07323a1a8b67e31962cd2f9ed8a36559b9ba59ba5305dff41` |
| PAMJA | `76ca45733291c8e9682a8efd5d117c93ad4a9bea1b6e104a270f03531f3ecb1e` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `1d4c07bb5ef91ac6fd05cbd754ccaf65b24f1a33bbee193f39e5643fd19fb591` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `05fd12c73e666390d825ec78dbf996bd3e8990e77e2d97cbe701da17a7d0f007` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/1d4c07bb5ef91ac6fd05cbd754ccaf65b24f1a33bbee193f39e5643fd19fb591`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET

# Akuza të forta nga protesta: Rama dhe Vuçiç, arkitektët e ndarjes së Kosovës

Piranjat Përditësimi i fundit 14 Shtator 2026, 20:42




Qytetarët kanë vijuar për të 107-ën ditë radhazi protestën para Kryeministrisë, duke kërkuar largimin e kryeministrit Edi Rama dhe qeverisë së tij.

Gjatë tubimit kanë marrë fjalën edhe qytetarë të ndryshëm, të cilët kanë artikuluar kritika ndaj qeverisjes dhe institucioneve.

Një protestuese e cilësoi “shkombëtarizimin” si një nga rreziqet kryesore me të cilat, sipas saj, përballet sot vendi. Ajo pretendoi se ky proces është zhvilluar në dy faza, fillimisht përmes asaj që e konsideron shkatërrim të infrastrukturës dhe më pas përmes shitjes së trojeve.

“Të nderuar qytetarë, atdheu ynë është në rrezik. Kjo qeveri e korruptuar, kjo politikë 36-vjeçare ka realizuar këtë shkombëtarizim në dy faza. E para, shkatërrimi i infrastrukturës. E dyta, erdhi me shitjen e trojeve shqiptare”, deklaroi ajo.

Në fjalën e saj, protestuesja lëshoi akuza edhe ndaj Policisë së Shtetit, të cilën e cilësoi si të nënshtruar ndaj pushtetit. Ajo kritikoi veçanërisht mënyrën se si policia ka vepruar ndaj pjesëmarrësve në protesta.

“Nuk duan të kuptojnë sistemin, një polici që me kostum dhe pa kostum është e përgjumur. Një polici e përgjunjur para pushtetit, arreston protestuesit, disa prej tyre gra e fëmijë”, tha protestuesja.

Ajo përdori tone të forta edhe ndaj Parlamentit, duke kërkuar shpërndarjen e tij dhe largimin e qeverisë.

“Më mirë shpërndajmë parlamentin sesa kthejmë Shqipërinë në Palestinë. Jo kryeministër, më mirë shpërndajmë parlamentin”, u shpreh ajo.

Në vijim, protestuesja iu rikthye edhe zhvillimeve të vitit 2020 dhe debatit të atëhershëm për një ndryshim të mundshëm të kufijve mes Kosovës dhe Serbisë. Ajo pretendoi se kryeministri Edi Rama dhe presidenti serb Aleksandar Vuçiç kishin qenë pjesë e një skenari për ndarjen e Kosovës.

“Më 24 qershor të 2020 u ndërpre udhëtimi i një shqiptari i cili ishte nisur për në Washington për të nënshkruar ndarjen e Kosovës. Një prej arkitektëve të ndarjes së Kosovës ishte Rama dhe Vuçiç. E njëjta situatë është edhe sot me Shqipërinë”, deklaroi ajo.

## Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 14 Shtator20:39

### ["Me taksat e karburantit, meritoni vetëm përçmim"/ Pankartat nga protesta e 107-të kundër Ramës]

Protesta në Tiranë ka shënuar ditën e sotme 107 ditë të revoltës qytetare. Qytetarët kanë nisur si fillim grumbull...

AKTUALITET 14 Shtator20:31

### [Aktivistja: Do të vijojmë bllokimin e institucioneve dhe Kuvendit. Nuk na përfaqësojnë]

Dhuna e pretenduar policore gjatë protestës së 107-të kundër qeverisë së Edi Ramës ka sjellë reagimin e protestuesv...

AKTUALITET 14 Shtator20:22

**["Nuk kanë forca të menaxhojnë situatën në bulevard"/ Protestuesi: Frontin nuk do e lëshojmë, jemi afër fitores]**

Një qytetar pjesëmarrës në tubimin përballë godinës së Kryeministrisë në ditën e sotme, ka marrë fja...

AKTUALITET 14 Shtator20:12

**[EMRAT/ Fermë droge prej 4.5 milionë paund në klubin e natës, kush janë tre shqiptarët që u hodhën nga çatia e ndërtesës. Ja kush i 'tradhtoi']**

Një shtetas shqiptar është dënuar me burg për rolin e tij si kultivues në një fermë kanabisi me vlerë 4.5 milion&eu...

AKTUALITET 14 Shtator20:04

**[Polici goditi me grusht protestuesin, Krenar Ahmeti: Sjellje brutale, u shkel çdo lloj norme]**

Ish efektivi i Policisë, Krenar Ahmeti komentoi dhunën e ushtruar nga një polic ndaj një qytetari sot gjatë protestës së zh...

AKTUALITET 14 Shtator19:48

**["Revolta kur ndizet nuk ndalet", Tepelena: Balluku me vilë sekrete, pensionistët mezi blejnë ilaçet]**

Protesta kundër qeverisë ka vijuar për të 107-ën ditë radhazi para Kryeministrisë, ku qytetarët janë mbledhur s&eum...

AKTUALITET 14 Shtator19:40

**[Shkrirja e Divjakës me Lushnjën, bashkia mbledh argumentet kundër: Relacioni shkon në Kuvend]**

Komisioni i ngarkuar nga Këshilli Bashkiak i Divjakës për përgatitjen e relacionit kundër shkrirjes së Bashkisë Divjakë,...

AKTUALITET 14 Shtator19:39

**["AMG Food" e skandalit të Salmonelës, pronare e kontejnerit me mish pule ku u gjetën 41 kg kokainë]**

Detaje të reja kanë dalë në dritë nga operacioni i zhvilluar ditën e sotme në Portin e Durrësit, ku Policia sekuestroi 4...

AKTUALITET 14 Shtator19:34

**[Akuzohet se abuz*i me mbesën, 51-vjeçari shqiptar lihet në burg! Hetimet zbulojnë fakte të tmerrshme edhe me të bijën]**

Me vendim unanim të gjyqtarit hetues dhe prokurorit, 51-vjeçari me origjinë shqiptare u la në paraburgim për abuzim seksual ndaj mbes...

AKTUALITET 14 Shtator19:15

**[Nuk ndalet revolta kundër Ramës, nis marshimi qytetar drejt Kryeministrisë]**

Qytetarët kanë dalë sërish në rrugët e Tiranës këtë të hënë, duke shënuar ditën e 107-t&eu...

## ME TE VIZITUARAT

BOTA 13 Shtator

**["Kaos" në fluturimin Australi-Katar/ Dy burra p...]**

Një incident është regjistruar në bordin e një fluturimi nga Melburni drejt Dohas, ku dy pasagjerë meshkuj u bënë agre...

AKTUALITET 13 Shtator

**[Të shtëna me armë pranë një lokali në Greqi, dy...]**

Shqiptari Alket Rizai, ish-bashkëpunëtor i të shumëkërkuarit grek Vasilis Paleokostas dhe i njohur për arratisjen dy herë m...

AKTUALITET 13 Shtator

**[E rëndë në Patos, një person gjendet i pa jetë ...]**

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pak më parë në Patos.Një person është gjetur i pa jetë në oborrin e bane...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

**[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik]**

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

**video**



**Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**





**Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**




**Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave**





PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.